

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-22-11947-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	JAGUAR SECURITY SH.P.K.
NUI	811558199
Adresa	Rr.Faik Konica p.n
Vendi	Prizren
Kodi postar	20000
Numri Telefonit	048100150
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Amir Tershani
Adresa elektronike	info@jaguarcom.al
Data e parashtrimit të ankesës	25.01.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut

Njoftimi për kontrate, 18.11.2022

Hapja e tenderëve, 27.01.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Po me datën 22.01.2023 kemi dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktues kërkesën për rishqyrtim si pale e pakenaqr me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë për shkak të disa kërkesave dhe kriterëve të vendosura.

Me datën 23.01.2023 kemi pranuar vendimin nga ana e Autoritetit Kontraktues duke na refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Te njëjtë në vendimin me nr.342 të datës 23.01.2023 kanë lënë një shenim shtesë, ku potencojnë se afati për dorëzimin e tenderëve nuk do të ndryshoj edhe pse na jepet e drejta e ankimit pranë OSHP-se në afatin prej 10 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat ligjore të cilat supozohet se janë shkelur nga Autoriteti Kontraktues:

Ligji për Prokurimin Publik i Republikës së Kosovës nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 si dhe Rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Për shkak se platforma elektronike e E-prokurimit është perditesuar me modulin e ri të ankesave, po shfaqen probleme teknike në kopjimin e tekstit të shënuar në formën standarde të ankesës, gjë për të cilën kemi hapur rast dhe kemi kërkuar ndihmë nga Help Desku. Deri në rregullimin e këtij problemi teknik në sistemin e platformës së E-prokurimit jemi udhëzuar që dokumentin e formës së vjetër të ankesës ta ngarkojmë si shtojcë.

Bashkangjitur gjëni formën e vjetër standarde të ankesës ku i kemi paraqitur të gjitha pretendimet tona ankimore.

Shtojcë: Ankesa në formatin word (.docx)

Poashtu gjatë fazës së ankimit mendojmë se do ta plotësojmë ankesën tonë në vazhdimësi para se ekspertët shqyrtues të japin vendimin e tij.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mos largimi i kërkesave të tepërta, si dhe mos vendosja e kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional si dhe atë ekonomik-financiar, rrezikon pjesëmarrjen e kompanive serioze, dhe rrezikon ekzekutimin e kontratës nga kompani jo serioze që nuk kanë asnjë kapacitet dhe fuqi financiare për ekzekutimin e një kontrate serioze si kjo.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*